REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 31367/25
Nr. i fq. / Br. st. -3-
Data: / Datum: 07.07.25
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**Komuna e Vushtrrisë**
**Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri**

---

**Drejtoria e Arsimit**

10 Nr. 483 /25

Datë: 07.07.2025

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 "Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës" dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret për regjistrim të nxënësve në klasën e (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe aftësimit Profesional të shpallura nga MASHTI, nr. 3/2497 dt.01.07.2025.

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL**

**KONKURS**

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË GJIMNAZ DHE NË SHKOLLAT TEKNIKE DHE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2025/26

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri:**

| SHKOLLA | Drejtimi | Nr. i Paraleleve | Nr. Nxënësve në një paralele | Gjithsej për drejtim |
|---|---|---|---|---|
| Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri | Shkenca natyrore | 6 | 22 | 132 |
| | Shoqërorë – Gjuhësor | 5 | 22 | 110 |
| Gjithsej: | | 11 | 22 | 242 |

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X ) për shkolla Teknike dhe Profesionale në Vushtrri**

| Shkolla | Drejtimi | Profili | Nr.i paral. | Nr.i nxën. |
|---|---|---|---|---|
| sHMLT "Lutfi Musiqi" | Makineri, prodhim dhe ndërtimtari | Zdrukthtari-DUAL | 1 | 22 |
| | | Operator i prodhimit | 1 | 22 |
| | | Dirigjimi kompjuterik i makinave | 1 | 22 |
| | | Automekanik-DUAL | 1 | 22 |
| | | Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujesjellesit | 1 | 22 |
| | | Trafik rrugorë | 1 | 22 |
| | Teknologji e informacionit dhe komunikimit | Zhvillues i aplikacioneve | 1 | 22 |
| | | Teknik i informatikës së biznesit | 1 | 22 |
| | | Mekatronikë | 1 | 22 |
| | | Energjetikë | 1 | 22 |
| | | Instakues elektrik | 1 | 22 |
| | **SHMT"Lutfi Musiqi"Vushtrri** | **Gjithsej:** | **11** | **242** |
| SHMLP " Bahri Haxha" | Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinari | Agrobiznes | 2 | 44 |
| | | Hortikulturë | 1 | 22 |
| | | Përpunues i ushqimit dhe profesione të ngjajshme | 1 | 22 |
| | Makineri, prodhim dhe ndërtimtari | Arkitekturë | 1 | 22 |
| | | Teknologji e riciklimit | 1 | 22 |
| | | Laborant i kimisë | 1 | 22 |
| | | Përpunimi i metaleve | 1 | 22 |
| | Ekonomi, administrim dhe juridik | Marketing | 1 | 22 |
| | | Kontabilist | 1 | 22 |
| | | Tregti me shumicë dhe pakicë | 1 | 22 |
| | Shërbime | Kuzhinier | 1 | 22 |
| | Art | Konfeksion | 1 | 22 |
| | **SHMP"Bahri Haxha"Vushtrri** | **Gjithsej:** | **13** | **286** |

**Dokumentet e nevojshme për Aplikim**

Nxënësit për të aplikuar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën aplikon)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.
- Dëftesën e nostrifikuar në MASHTI ( vlen vetëm për nxënësit që kanë mbaruar klasën nëntë (IX) jashtë Kosovës).

**Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2025/2026, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; https://kk.rks-gov.net/vushtrri/

**Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

-Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2025/2026, bëhet në datat: **08, 09, dhe 10 korrik 2025** duke filluar nga ora **8:00-16:00**, në shkollat përkatëse.
-Shpallja e rezultateve më **11.07.2025**
-Tërheqja e dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet me 14.07.2025 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

**AFATI I ANKESAVE`**

Kandidatët e pakënaqur me rezultatin e publikur, kanë të drejtë ankese në afat prej dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqesin ankesë drejtorisë së shkollës.

Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

DKA shqyrton vetëm ankesat, për të cilat shkolla përkatëse ka ofruar përgjigje dhe vetëm në shkallën e dytë.

Albanez Tahiraj

Drejtori i DKA-së